



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 24.10.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **17.10.2025**, të parashtruar nga **NOVUS SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH"** me nr. prokurimi 206-23-13309-1-1-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE NOVUS SH.P.K. e dt. 17.10.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH"** me nr. prokurimi **206-23-13309-1-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK, të datës 13.10.2025;
2. **Mbetet në fuqi**, Njoftimi mbi vendimin e AK, i datës 13.10.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, e konsideron të mbyllur aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

NOVUS SH.P.K. (Grupi i OE: PACS and Workflow System), me datën 17.10.2025, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH"** me nr. prokurimi 206-23-13309-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 24.10.2025, e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

Ligji Nr. 04/L-042 Për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës ("LPP")

Neni 7 – Barazia në Trajtim/ Jodiskriminimi – Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të it te një ose më shume operatoreve ekonomik.

Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve – AK nuk vlerëson ofertën e OE Pacs and Workflow System në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me Dosjen e Tenderit, kjo pasi që OE në fjalë ka plotësuar të gjitha kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga AK, për çka oferta e të njëjtit duhet të konsiderohet si e përgjegjshme.

Neni 60 – Kriteret për Dhënien e Kontratës – Nëse autoriteti kontraktues ka përcaktuar në dosjen e tenderit se kontrata publike do ti jepet operatorit ekonomik që dorëzon it ë gjs e it ë gjshem ekonomikisht më të favorshëm, dhënia e kësaj kontrate do të bëhet vetëm në bazë të kriterëve dhe peshës së tyre përkatëse të përcaktuar në dosjen e tenderit në pajtim me paragrafët 2. Dhe 3. Të nenit 52 të këtij ligji.

Neni 62 – Përfundimi I Aktivitetit të Prokurimit – AK mund të anulojë/përfundojë aktivitetin e prokurimit në rast se: të gjithë tenderët e it ë gjshem përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; ka ndodhur ndonjë shkelje ligjore; apo kur një gjë e tillë është bërë e nevojshme, para hapjes së tenderëve, për shkak të ngjarjeve objektive jashtë kontrollit të AK.

Rregullorja Nr.001_2022 për Prokurimin Publik (“Rregullorja për Prokurim”)

Neni 43.5 – Ndërprerja e procedurave të prokurimit – Nuk janë paraqitur asnjë nga arsyet për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet – Pretendimet ankimore te OE ankues:

OE Pacs and Workflow System paraqet këtë Kërkesë për Rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues të it ë 13.10.2025 për aktivitetin e prokurimit me nr. 206-23-13309-1-1-1, me të cilin AK e anulon aktivitetin e prokurimit duke e vlerësuar ofertën e OE Pacs and Workflow System and Workflow System it ë papërgjegjshme.

Me rëndësi esenciale, veprimet e Autoritetit Kontraktues paraqesin veprime të paligjshme dhe veprime të cilat refuzojnë të zbatojnë vendimet përfundimtare dhe meritore të OSHP-së, e cila vecse ka vendosur tri (3) it për të njëjtin tender. Në tri (3) raste, OSHP-ja, mbështetur edhe nga ana e ekspertit shqyrtues, ka konstatuar se kemi paraqitur ofertë të përgjegjshme, dhe rrjedhimisht kualifikohemi për dhënie të Kontratës.

Me it ë g u paralajmërojmë, se në përputhje me Nenin 131 të LPP-së dhe në përputhje me Rregullores së Punës së OSHP, në rast të refuzimit të kësaj Kërkese për Rihqyrtim, do të jemi të detyruar të kërkojmë masa ndëshkimore ndaj Autoritetit Kontraktues dhe zyrtarëve përgjegjës, kjo për shkak të diskriminimit dhe refuzimit të zbatimit të vendimeve detyruese të OSHP-së.

Ndërmarrja e masave ndëshkimore ndaj Autoritetit Kontraktues dhe zyrtarëve të prokurimit gjithashtu është paralajmëruar edhe në it ë gj e fundit të OSHP-së, OSHP: 2025/0060 (shih faqe 12 të vendimit).

AK ka vlerësuar se OE Pacs and Workflow System nuk ka dorëzuar një ofertë të përgjegjshme për shkak se:

(1) OE nuk I ka përmbushur Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nga pika 9.1 & 9.2 e Seksionit II- Fleta e të dhënave të Tenderit (FTD), të DT. Edhe kësaj rradhe, AK pretendon se OE nuk ka ofruar mjaftueshëm dëshmi ligjërish të vlefshme të cilat vërtetojnë se produkti është implementuar suksesshëm në shumë lokacione.

(2) OE nuk ka ofruar dëshmi se ka zbatuar me sukses projekte të natyrës së njëjtë gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. AK pretendon se it e paraqitura në it ë e referencave nuk korespondojnë me datën e paraqitur nga OE.

(3) OE nuk ka ofruar dëshmi për implementimin e mekanizmit të tyre PACS në ndonjë shtet anëtar të BE-së.

(4) OE nuk ka përmbushur kërkesat për stafin it ë gjshem sipas Dosjes së Tenderit.

Në kundërshtim të kësaj, OE Pacs and Workflow System paraqet pretendimet it ë vijim:

(1) OE Pacs and Workflow System ka plotësuar të gjitha pjesët obligative të Dosjes së Tenderit;

(2) OE Pacs and Workflow System ka paraqitur ofertë të përgjegjshme;

(3) Nuk janë plotësuar kushtet ligjore për anulimin e aktivitetit të prokurimit

Pretendimi ankimor 1:

OE PACS AND WORKFLOW SYSTEM KA PLOTËSUAR TË GJITHA PJESËT OBLIGATIVE TË DOSJES SË TENDERIT

Në këtë kërkesë të katërt për rishqyrtim të tenderit, OE do ri-pohojë se ka plotësuar të gjitha pjesët obligative të dosjes së tenderit. Në Njoftimin e Vendimit të AK, të it ë 13.10.2025, AK ri-vlerëson Ofertën it ë papërgjegjshme për këto arsye:

1) Nuk është përmbushur kërkesa që përmes it ë gjsh të vërtetohet implementimi I sistemit;

2) Referencat e ofruara nga OE nuk I përkasin projekteve të përfunduara, por janë ende në it ë g të zbatimit prandaj nuk përmbushin kërkesën e it ë 9.1 & 9.2 të Seksionit II, DT;

3) OE nuk ka dëshmuar implementimin e mekanizmit të tyre PACS në ndonjë shtet anëtar të BE-së;

4) OE nuk ka përmbushur të gjitha kërkesat profesionale të Dosjes së Tenderit;

5) Oferta e OE nuk plotëson të gjitha kërkesat teknike për shkak se:

a) Propozimi nuk përmban përshkrime për mekanizmat e sigurisë së qasjes në të dhëna, specifikisht opsionin e një bezeli sigurie në kasë të serverit;

b) Moduli I ofruar nuk përfshin 4 porta 10/25GbE SFP28, dhe as SFP transceiver-ët përkatës;

c) Procesori I ofruar nuk arrinë kërkesën minimale 2.0 GHz;

d) Monitori mjekësor I ofruar nuk përmbush plotësisht kushtet teknike të kërkuara.

Pas krahasimit të it ë gjshem it ë 05.06.2025, me Njoftimin e it ë 13.10.2025, shihet se AK, në mes të pretendimeve të kaluara, ka shtuar pretendime për të cilat më it nuk e ka konsideruar ofertën e OE it ë papërgjegjshme. Në tre njoftimet e para, AK nuk ngritë çdo çështje që ka ngritur tani, prandaj duhet theksuar se AK nuk e ka vlerësuar ofertën it ë papërgjegjshme në bazën e çështjeve të reja të ngritura aktualisht në Njoftimin e it ë 13.10.2025.

Duke qenë se AK ka eliminuar OE Pacs and Workflow System për arsye të cilat më it e ka vlerësuar it ë it ë gjshem, AK është në shkelje të nenit 7 të LPP-së I cili siguron trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomik, ashtu që ofertën e përgjegjshme të OE Pacs and Workflow System vazhdon ta vlerësoj it ë papërgjegjshme çdoherë për arsye të ndryshme vetëm me qëllim të eliminimit të tij dhe të anulimit të aktivitetit të prokurimit.

Një veprim I tillë është në kundërshtim edhe me nenin 60.7 të Rregullores për Prokurim, I cili përcakton se kthimi në rivlerësim nga OSHP nuk nënkupton një ndryshim të rezultatit fillestar. Në të gjitha instancat e rikthimit në vlerësim nga OSHP për këtë aktivitet të prokurimit, AK ka ndryshuar vlerësimet e saj mbi ofertën e OE Pacs and Workflow System, gjë që përforcon qëndrimin se AK ka për qëllim që të eliminoj ofertën e OE Pacs and Workflow System në çdo mënyrë të mundshme dhe të anuloj aktivitetin e prokurimit.

Kështu, në vijim do të argumentojmë se OE Pacs and Workflow System ka paraqitur ofertë të përgjegjshme dhe si e tillë duhet të shpërblehet me kontratë, për shkak se asnjë nga pretendimet e lartcekura të AK nuk qëndron.

Pretendimi ankimor 2:

OE PACS AND WORKFLOW SYSTEM KA PARAQITUR OFERTË TË PËRGJEGJSHME

1) AK, edhe kësaj rradhe, pretendon se OE nuk ka përmbushur kërkesën e paraqitur në pikat 9.1 dhe 9.2 për “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale”, Seksioni II i FTD. AK në këtë Vendim, ndryshe nga dy vendimet e kaluara, pretendon se nuk ka mjaftueshëm dëshmi ligjërish të vlefshme sa i përket demonstrimit që produkti është implementuar në shumë vende.

AK konteston se dokumentacionit të ofruar nga OE i mungon vula zyrtare dhe nuk përmbanë dëshmi të drejtpërdrejta nga marrësi i shërbimeve që është Ministria e Shëndetësisë së Lituanisë. Gjithashtu, pretendohet se dokumenti i ofruar në pyetje sqaruese nuk është ofruar nga Ministria e Shëndetësisë, që është përfituesi, por nga njëri prej anëtarëve të konsorcium, me ç'rast nuk plotësohen kërkesat nga AK, pasi që nga AK është kërkuar që të ofrohet referencë nga klienti, elementet e së cilës janë vula, nënshkrimi, të cilat janë thelbësore për të vërtetuar vlefshmërinë dhe bazueshmërinë ligjore të kërkesës.

Duhet theksuar se dosja e tenderit nuk përmban kërkesën që referenca për implementimin e produktit të jetë e vulosur dhe e nënshkruar nga klienti përkatës. Dëshmitë dhe dokumentacioni i dorëzuar sa i përket klientit Ministria e Shëndetësisë së Lituanisë përmban të gjitha elementet të cilat kërkojnë për të konfirmuar se është implementuar me sukses projekti me arkitekturë me shumë faqe. Për më tepër, dosja e tenderit kërkon që me referencë të përfshihet edhe informatat kontaktuese për klientin ashtu që të mund të verifikohet kërkesa. Këto informata janë të përfshira në referencë, ku paraqitet personi kontaktues Osvaldas Grubys, së bashku me emailin kontaktues të tij.

Në këtë drejtim, AK ka shkelur nenin 60.2, i cili shprehimisht ndalon shtimin e kriterëve të reja nga dosja e tenderit pas pranimit të tenderëve, duke kërkuar që referenca të jetë e vulosur nga klienti. Dëshmia e dorëzuar përmes MedDream si pjesëtar i grupit të operatorëve ekonomik përmban të gjitha elementet e kërkuara nga dosja e tenderit dhe oferta e OE Pacs and Workflow System është tërësisht e përgjegjshme në lidhje me këtë kërkesë.

2) AK pretendon se OE nuk ka ofruar dëshmi se ka zbatuar me sukses projekte të natyrës së njëjtë gjatë tre viteve të fundit, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. AK argumenton që datat e dokumenteve të paraqitura paraprakisht nga OE, dhe ato të paraqitura nga OE pas Kërkesës për sqarim e AK nr.4, nuk korespondojnë. Megjithatë, ky argument është i pabazë.

Paraprakisht, OE kishte specifikuar kohëzgjatjen e projektit të ngjajshëm nga 10.12.2021 dhe në vazhdueshmëri. Pas Kërkesës së lartcekur të AK për sqarim, OE klarifikon se arsyeja pse projekti është cilësuar si “në vazhdueshmëri”, është për shkak se projekti–veçse i implementuar–kërkon mirëmbajtje, të cilën OE e ofronte. Në përgjigjjen sqaruese të OE, OE bashkangjet si provë referencën e palës përfituese nga Zelanda e Re, e cila konfirmon se në dhjetor 2021, siç është paraqitur në dokumentet e mëparshme të OE, është bërë implementimi i suksesshëm i projektit gjatë tre viteve të fundit, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë; prandaj, OE përmbushë kërkesën në pikat 9.1 & 9.2 të Seksionit II të DT.

Rrjedhimisht, është e qartë nga dokumentacioni i dorëzuar se datat e përmendura përputhen me të dhënat kontraktuale, pasi që kontrata përfshinë faza të ndryshme të projektit, përderisa sistemi ka hyrë në prodhim dhe licensa është aktivizuar në Dhjetor 2021, në përputhje me datën e deklaruar nga OE Pacs and Workflow System. Për të verifikuar këtë, referenca e bashkëngjitur po ashtu përmban detajet e kontaktit përmes së cilës referenca mund të verifikohet. Megjithëse po këtë argument OE e ka ofruar dhe gjatë kërkesës së kaluar për rishqyrtim, siç shihet argumentet nuk janë shqyrtuar me mirëbesim.

3) Në Vendimin e datës 05.06.2025 AK nuk kishte ngritur si bazë për eliminim pretendimin se OE nuk ka ofruar dëshminë e realizimit të një projekti të ngjashëm në një shtet të BE-së. Megjithatë, në Vendimin e fundit të datës 13.10.2025, AK vendosi që të ngritë përsëri këto pretendime, edhe pse janë hedhur poshtë paraprakisht sepse OE është shpallur konformues edhe në këtë çështje.

Për këtë kërkesë OE 'PACS and workflow System' ka ofruar 2 referenca/projekte të implementuara. Njëra për zgjidhjen Pinga produktin/RIS, si dhe tjetra për zgjidhjen MedDream PACS. Për te dy projektet multi-site të implementuara janë dhënë referencat e kontaktit për tu kontaktuar dhe verifikuar projektet e implementuara. Zgjidhja teknike e ofruar tregon se si zgjidhja e workflow dhe PACS janë implementuar me sukses në disa arkitektura multi - site. Për shembullin e RIS, ne zgjidhjen e ofruar nga OE 'PACS and workflow System', me saktësisht në seksionet 2.8.1 – 2.8.9, tregohet arkitektura për një implementim workflow multi-site, së bashku me një kontakt që mund të ofrojë informacion shtesë. Për shembullin e PACS, ne zgjidhjen e ofruar nga OE 'PACS and workflow System', me saktësisht në seksionin 2.8.10, tregohet arkitektura për një implementim multi-site të PACS, së bashku me një kontakt që mund të ofrojë informacion shtesë. Ju mund ti kontaktoni personat përgjegjës dhe patjetër që këto referenca/projekte mund të vërtetohen që janë të implementuara.

Mbi bazën e të gjithë kësaj që është paraqitur nga ana e OE-së, AK është përgjigjur me atë që nuk ka ndonjë deklaratë bindëse në të cilën dëshmohet që një projekt i ngjashëm është implementuar në ndonjë vend të EU-së, dhe me këtë të gjitha deklaratat i ka konsideruar se nuk japin siguri dhe se janë të përgjithësuara.

Por, ky pretendim i AK nuk qëndron pasi në faqe 56 të Propozimit teknik apo pika 2.8.9 theksohet se është zhvilluar një projekt i ngjashëm në Serbi, dhe poashtu pika 2.8.10. Përcakton një akriteturë në disa faqe (multi-site architecture) për Meddream PACS në Lituani.

Duke qenë se Lituania është një shtet në BE atëherë kjo kërkesë specifike konsiderohet automatikisht si e përmbushur nga ana e OE-së. Poashtu OE ka dhënë edhe detaje lidhur me strukturën e arkitekturës së projektit të zhvilluar dhe të njëjtën kohë e ka dhënë edhe kontaktin e referencës lidhur me projektin e zhvilluar të ngjashëm në projektin e BE-së.

4) AK argumenton se stafi profesional i ofruar nga OE nuk është konformues ndaj kërkesave teknike/profesionale në Dosje të Tenderit. Edhe kjo pikë është risi e këtij Vendimi të fundit të datës 13.10.2025, dhe paraprakisht nuk është konsideruar si bazë për eliminim prandaj nuk duhet të rishqyrtohet, siç është elaboruar më lart. Mirëpo, duke qenë se edhe në këtë pikë OE është i përgjegjshëm, përsëri do kundërargumentohet.

Kërkesa për stafin profesional, e cila pretendohet që nuk është përmbushur, përcakton kërkesën si më poshtë:

“Dy (2) zhvillues të lartë me një eksperiencë minimale prej 8 vitesh në zhvillimin e produkteve të ofruara RIS dhe PACS në projekte të ngjashme ose në projekte IT me kompleksitet të ngjashëm, minimum të **certifikuar për zhvillimin dhe administrimin e sistemeve në platformën që ofron dhe me diplomë minimale bachelor. në fushat e IT.**”

“Kopje CV me të gjitha detajet, diplomën dhe certifikatat e kërkuara”

AK pretendon se propozimet e OE në listën e stafit për zhvillues softuerësh nuk përmbushin kërkesën e lartcekur. AK pretendon se certifikatat e ofruara nga prodhuesi i softuerit “Softneta” nuk janë të vlefshme, ndërsa është dashur që të certifikohen nga “Microsoft” ose “Oracle”.

Ky pretendim është tërësisht i pabazë, siç mund të vërtetohet përmes një leximi të thjeshtë të kërkesës. AK për qëllimet e veta tendencioze përgjatë shqyrtimit është duke tentuar të shtojë kritere që paraprakisht nuk kanë ekzistuar. Sipas kërkesës, zhvilluesit e lartë duhet të ofrojnë certifikata për zhvillimin dhe administrimin e sistemeve në platformat e ofruara, gjë që saktësisht është bërë nga OE, sepse platforma e ofruar është produkt i Softneta. Asnjëherë në tekstin si më lart nuk specifikohet si kërkesë certifikata për ndonjë softuer të jashtëm i cili nuk po ofrohet nga OE, për shembull “Microsoft” ose “Oracle”.

Pra, përkundër pretendimeve tendencioze të AK, OE është përgjegjës dhe në këtë pikë.

5) AK ka rivlerësuar ofertën si të papërgjegjshme duke kontestuar përshtatshmërinë e Katalogut të ofruar nga OE dhe Kërkesave të përcaktuara në DT. Katalogu i OE është në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit

- a) AK së pari konteston përputhshmërinë e Serverit të ofruar nga OE në krahasim me kërkesën sa i përket Serverit Qëndror, e qasshme tek Specifikimet Teknike në Dosjen e Tenderit. AK pretendon se Serveri i ofruar nga OE, i cili është Dell PowerEdge R760xd2, nuk përshtatet me kërkesën e “opcionit për një panel të përparëm të kyçshëm në kasën e serverit, që kufizon qasjen në hard disqe.”, mirëpo ky pretendim është i pabazë.

Dell PowerEdge R760xd2 me të cilin është ofruar e përmban këtë option të bezel, ashtu si mund të konfirmohet nga linqet më poshtë:

chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://dl.dell.com/content/manual24680455-dell-poweredge-r760-installation-and-service-manual.pdf?language=en-us

Përkatësisht, në faqen zyrtare të prodhuesit DELL, përcaktohet se: *“The Dell PowerEdge R760xd2 server features a lockable front bezel designed to enhance physical security by restricting unauthorized access to the drive bays and system controls. This bezel can be secured using a key lock mechanism, ensuring that only authorized personnel can access the server's front components.*

Dokumentacioni zyrtar i Dell konfirmon se modeli R760xd2 përfshin ose ofron si aksesor opcionin “Lockable Front Bezel”, që mund të porositet dhe vendoset për mbrojtje fizike të kasës së serverit.

Linku referues:

https://www.dell.com/en-us/shop/dell-poweredge-servers/poweredge-r760-rack-server/spd/poweredge-r760/pe_r760_15724_vi_vp

Pamjet nga konfiguratori zyrtar i Dell (si në fig. më poshtë) tregojnë qartë që për modelet PowerEdge R750/R760xd2 ekziston optioni:

- PowerEdge 2U LCD Bezel
- PowerEdge 2U Standard Bezel
- ose No Bezel (nëse klienti zgjedh të mos e përfshijë).

Kjo dëshmon se **Bezel është komponent zyrtar i modelit të ofertuar** dhe mund të përfshihet sipas kërkesës së tenderit. E që ne rasti e OE është ofruar pasi që kërkesa ka qenë e ofruar.

Pra, bazuar në dokumentacionin teknik dhe specifikimet e prodhuesit DELL, modeli i ofruar R760xd2 përmbush kërkesën për opcionin e panelit të përparëm të kyçshëm (Lockable Front Bezel).

Si rrjedhojë, pretendimi i AK-së se serveri nuk përputhet me kërkesën është pa bazë teknike dhe bie ndesh me të dhënat zyrtare të prodhuesit.

- b) Sa i përket pjesës së ofrimit të modulit 4 x 10/25GbE SFP28, bazuar në ofertën teknike të paraqitur nga OE, është specifikuar se moduli përfshin 4 porta 10/25GbE SFP28, duke përfshirë gjithashtu edhe SFP transceiver-të përkatës.

Shih më poshtë ofertën e dorëzuar nga OE për këtë komponentë.

Must have at least: 1 module with at least 4 x 10/25GbE, SFP28 ports with included appropriate SFP transceivers. OCP 3.0 Network Adapters: Broadcom 57504 Quad Port 10/25GbE, SFP28, OCP NIC 3.0
--

Pra, në këtë pikë OE Pacs and Workflow System është tërësisht i përgjegjshëm.

- c) Po ashtu, AK konteston përputhshmërinë e frekuencës së Procesorit Intel i9-13900 vPro që do përdoret në Kompjuterët Dell Precision 3460 SFF, të ofruar nga OE, me Kërkesën e AK, që kërkon për një minimum 1.5 GHZ sa i përket bërthamave të efikasitetit, dhe minimum 2.0 GHZ sa i përket bërthamave të performancës. Për shkak se katalogu zyrtar i Dell thotë se Frekuenca e këtyre procesorëve është 1.5-5.6 GHZ, pa bërë ndasinë mes minimeve të bërthamave efikase dhe atyre të performancës, AK pa bazë supozon që minimumi i frekuencës së bërthamave të performancës nuk është arritur. Në realitet, faqja zyrtare e Intel, prodhuesve të këtyre procesorëve, tregon se procesorët e ofruar arrijnë minimumin 2.0GHZ në bërthamat e performancës, siç e kërkon DT.

Bazuar në ofertën teknike të paraqitur nga Operatori Ekonomik për këtë kërkesë, është ofruar procesori Intel i9-13900.

Për më shumë detaje, shih më poshtë ofertën teknike të dorëzuar nga Operatori Ekonomik.

Processor: A - Intel® Core™ i9-13900 (36MB Cache, 24 Core (8+16), 2.0GHz to 5.6GHz (65W)) TDP
--

Specifikimet e mëposhtme janë të publikuara në faqen zyrtare të prodhuesit Intel për procesorin e ofruar:

Përshkrimi	Kërkesa sipas Dosjes së Tenderit	E ofruar nga OE (Intel® Core™ i9-13900)	Përputhshmëria
Modeli i procesorit	Intel® Core™ i9 ose ekuivalent	Intel® Core™ i9-13900 vPro	✓ Po
Numri i bërthamave (Cores)	Minimum 24 (8 Performance + 16 Efficient)	24 (8 Performance + 16 Efficient)	✓ Po
Numri i threads	Minimum 32	32	✓ Po
Cache	Minimum 36 MB Intel Smart Cache	36 MB Intel Smart Cache	✓ Po
Frekuenca e bërthamave të performancës (P-cores)	Minimum 2.0 GHz deri 5.2 GHz	2.0 GHz deri 5.6 GHz	✓ Po
Frekuenca e bërthamave të efikasitetit (E-cores)	Minimum 1.5 GHz deri 4.2 GHz	1.5 GHz deri 4.2 GHz	✓ Po
TDP (Thermal Design Power)	—	65 W	✓ Në normë
Përfundim	Kërkesa minimale teknike	Plotësisht e përmbushur nga OE	✓ Në përputhje të plotë

Shih linkun më poshtë për verifikim:

<https://www.intel.com/content/www/us/en/products/sku/230499/intel-core-i913900-processor-36m-cache-up-to-5-60-ghz/specifications.html>

Prandaj, edhe në këtë aspekt, oferta e OE Pacs and Workflow System është tërësisht e përgjegjshme.

- d) Në fund, AK pretendon se monitori mjekësor i ofruar nuk përmbush plotësisht kushtet teknike të kërkuara. Kjo për shkak se kalibrimi i ndriçimit në 600 cd/m² tejkalon kufirin e kërkuar prej 500 cd/m² dhe nuk është optimal për mjedise të kontrolluara diagnostikuese me ndrigim të ulët. Ndërkohë që kontrasti i lartë prej 2000:1 mund të duket si avantazh, ai nuk përkon me standardin e kërkuar prej 1500:1, i cili lidhet me sistemet ekzistuese të kalibrimit dhe algoritmet e diagnostikimit. Së fundmi, këndi i shikimit 178°/178° është jashtë specifikimit të kërkuar 176°/176°.

Bazuar në ofertën teknike të paraqitur, është ofruar specifikimi teknik i mëposhtëm, duke u theksuar se është propozuar një model më i avancuar sesa ai i kërkuar në dosjen e tenderit.

	6-Megapixel Medical Monitor (x70) Proposed model: BARCO CORONIS FUSION 6MP (MDCC-6530) MEDICAL MONITORS
Panel Type	Color (IPS)
Backlight	LED
Size	772 mm
Native Resolution	3280x2048 (16:10 aspect ratio)
Display Colors	10-bit colors (DisplayPort) : 1.07 billion (maximum) colors 8-bit colors: 16.77 million from a palette of 68 billion colors
Viewing Angles (H / V, typical)	178° / 178°
Brightness (typical)	1050 cd/m ²
Recommended Brightness for Calibration	600 cd/m ²
Contrast Ratio (typical)	2000:1
Response Time (typical)	18ms (on/off)

Note: As clarified during the time of request for claryfing, we have proposed the medical monitor technical specification based on the clarifications and the proposed model is above the requested specifications.

Gjithashtu, në krahasim ndërmjet kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe ofertës së Operatorit Ekonomik, modeli Barco i ofruar tejkalon specifikimet bazë të kërkuara për monitorin mjekësor 6-Megapixel dhe konsiderohet si një zgjidhje më cilësore dhe me e rekomanduar.

Kërkesa ne AK 6-Megapixel Medical Monitor		Ofruar nga OE	Komente
Brightness (typical)	1000 cd/m ²	1050 cd/m ²	Më i ndritshëm, më i përshtatshëm për ambientet klinike me ndriçim të lartë
Recommended Calibration Brightness	500 cd/m ²	600 cd/m ²	Jep më shumë fleksibilitet për cilësi të qëndrueshme të imazhit gjatë kalibrimit
Viewing Angle (H/V)	176° / 176°	178° / 178°	Kënd më i gjerë shikimi, i rëndësishëm për diagnozë të saktë
Contrast Ratio (typical)	1500:1	2000:1	Kontrast më i lartë për shfaqje më të qartë të detajeve në imazhet mjekësore
Response Time	25ms	18ms	Reagim më i shpejtë, i dobishëm për navigim të shpejtë përmes imazheve

Sipas Nenit 28, paragrafi 6, i LPP-së, AK nuk mund ta skualifikoj një operator ekonomik vetëm për faktin se shërbimi i ofruar nuk përputhet me specifikimet e formuluar. Në këtë drejtim, fakti se OE Pacs and Workflow System ka ofertuar me produkt më të avancuar dhe specifikacionet teknike të të cilave jo vetëm që përmbushin minimalisht specifikimet teknike por edhe i tejkalojnë ato, nuk mund të eliminohet si ofertë e

papërgjegjshme.

Për më tepër, bazuar në përgjigjet e datës 30.01.2024, AK ka pranuar që mund të ofrohet me zgjidhje ekuivalente, për aq kohë sa ajo përmbush kërkesën përkatëse të kësaj pike, e cila është tërësisht në përputhje me Nenin 28, paragrafin 6 të LPP-së.

1. Referencat: Specifikimi teknik për hardwere, monitore mjekësorë

Pyetja: Specifikimi për monitoret korrespondon vetëm me monitorin mjekësor EIZO (RX660 6MP 30" - RadiForce)

Kërkojnë që të ndryshohen parametrat e specifikimit në mënyrë që të aplikojnë për tender edhe shitesit e tjerë. Me këtë specifikim, marrkiz e tjera botërore nuk mund të aplikojnë, duke penguar kështu konkurrencën e drejtë në tender.

Përgjigja 1: Është e pramshme që të ofrohet monitori ekuivalent, me specifika të njëjta ose më të mira.

Si rrjedhojë, ofrimi i modelit BARCO CORONIS FUSION 6MP (MDCC-6530) nga OE është plotësisht në përputhje me kërkesat dhe sqarimet zyrtare të tenderit, pasi ky model:

- përmbush të gjitha kërkesat minimale teknike;
- tejkalon disa parametra kyç (ndriçim, kontrast, kënd shikimi, kohë reagimi);
- dhe është teknikisht ekuivalent apo më i avancuar se modeli i përmendur në referencë (EIZO RX660)

Duke qenë se AK vetë ka lejuar ofertimin e pajisjeve ekuivalente me specifika të njëjta ose më të mira, pretendimi i mëvonshëm për mospërputhshmëri të monitorit është i pabazuar dhe në kundërshtim me sqarimet zyrtare të dhëna gjatë procedurës së tenderit. Dhe rrjedhimisht, oferta e OE Pacs and Workflow System është tërësisht e përgjegjshme dhe si e tillë nuk është dashur të eliminohet.

Pretendimi ankimor 3:

NUK JANË PLOTËSUAR KUSHTET LIGJORE QË TË ANULOHEK AKTIVITETI I PROKURIMIT

Neni 62 i LPP-së, lexuar së bashku me nenin 43.5 të Rregullores për Prokurim, shprehimisht ka përcaktuar shkaqet për të cilat mund të përfundojë një aktivitet i prokurimit. Duke qenë se oferta e PACS and Workflow System është e përgjegjshme, nuk plotësohen kushtet për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Kjo përkundër se, siç kemi elaboruar edhe më sipër, OE Pacs and Workflow System ka dorëzuar ofertë të përgjegjshme dhe ekonomikisht të favorshme - me çmim nën vlerën e parashikuar nga AK.

Në raste të tilla, kur dorëzohet një ofertë e përgjegjshme dhe e cila i plotëson të dy kriteret vendimtare për t'u shpërblyer me kontratë, AK nuk mund të përfundojë aktivitetin e prokurimit, por duhet ta shpërblejë me kontratë OE që dorëzon një ofertë të tillë.

Përfundimisht, duhet theksuar se AK është duke tentuar që në mënyrë të kundërligjshme

dhe pa ndonjë arsytim, të shpall OE Pacs and Workflow System të papërgjegjshme në mënyrë që të tentoj të shpërblej kompanitë tjera me kontratë. Duhet theksuar se OSHP, e ka konsideruar Ankesën e fundit të OE Pacs and Workflow System, plotësisht si të bazuar në këtë drejtim AK, ka patur obligim që të shpall OE fituese të tenderit dhe të shpërblej të njëjtën me kontratë, dhe jo që të rivlerësoj Tenderin me kërkesa të reja.

Bazuar në të lartcekurat, me respekt, kërkojmë nga AK që, pas shqyrtimit të kësaj Kërkese, të merr:

VENDIM

- I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar Kërkesa për Rishqyrtim e paraqitur nga Operatori Ekonomik PACS and Workflow System.
- II. **ANULOHET** Vendimi i Autoritetit Kontraktues Ministria e Shëndetësisë, i datës 05.06.2025, për anulim të aktivitetit të prokurimit, dhe Letra Standarde për tenderuesin e eliminuar, e datës 13.10.2025 për eliminimin e OE Pacs and Workflow System and Workflow System nga ky aktivitet i prokurimit, dhe të shpërblehet OE Pacs and Workflow System me Kontratë;

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Operatori Ekonomik PACS and Workflow System është i detyruar të mbrojë interesat e tij ekonomike dhe ligjore. Rrjedhimisht, në rast të vazhdimit të veprimeve kundërligjore, OE në fjalë është i detyruar të veprojë me të gjitha mjetet ligjore në dispozicion, përfshirë kërkesat për kompensim të dëmeve eventuale të cilat kanë ndodhur dhe do të shkaktohen.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues (DSISH) rreth pretendimeve ankimore te OE Novus:

Pretendimet e juaja ankimore janë trajtuar nga AK dhe pas shqyrtimit të tyre mund të konstatojmë se janë të pa bazuara, ne vijim gjeni arsyetimet rreth pretendimeve.

Kuadri ligjor i zbatueshëm: Aktiviteti i prokurimit publik nr. 206-23-13309-1-1-1 është zhvilluar në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP) Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet Nr. 04/L-237, Nr. 05/L-068 dhe Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar). Po ashtu, zbatohen dispozitat e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, të cilat sqarojnë procedurat e vlerësimit, eliminimit dhe anulimit të tenderëve. Në këtë kuadër, çdo ofertë e dorëzuar duhet të jetë **“e përgjegjshme”**, bazuar në nenin 59.4 të LPP-se ku specifikohet se: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Zbatimi i vendimit të OSHP dhe baza për anulim: Pas vendimit të OSHP nr. 548/25 datë 29.08.2025, AK – Ministria e Shëndetësisë (MSh) – e ka zbatuar vendimin duke e kërkuar rivlerësimin e aktivitetit. Në përputhje me nenin 62 të LPP dhe nenin 43.5 (b) të Rregullores PP, AK përfundoi aktivitetin e prokurimit duke **anuluar tenderin për mungesë të ofertave të përgjegjshme**, meqenëse pas rivlerësimit rezultoi se asnjë ofertë e pranuar nuk plotësonte kërkesat (versioni i konsoliduar i Rregullores Nr. 001/2022 i plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, pika 43.5).

Kjo u komunikua zyrtarisht përmes formularit standard B58 më 13.10.2025, ku u theksua se oferta e grupit “PACS and Workflow System” u vlerësua e papërgjegjshme si në aspektin administrativ ashtu edhe teknik. Sipas rregullave në fuqi, **procedura e hapur e prokurimit duhet të anulohet kur asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm** (versioni i konsoliduar i Rregullores Nr. 001/2022 i plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, pika 43.5). Vendimi i AK-së për anulim bazohet pikërisht në këtë dispozitë detyruese, duke qenë se oferta e operatorit ekonomik (OE) ankues u konstatua e papërgjegjshme.

